



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:049480

Datë: 07.10.2024

Numri i dokumentit: 06338950

KF.nr.601/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin tregtar administrativ të paditësit “Ardi” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810517089, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners” Sh.P.K. ,me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekti i çështjes inkasim i mjeteve, vlera e kontestit 10,542.95 euro, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 27.09.2024 në prani të përfaqësuesit të palës paditëse Gentiana Behluli dhe përfaqësuesit të palës së paditur Krenare shala, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Ardi” Sh.P.K. me numër unik identifikues 810517089 dhe seli në Prishtinë.
- II. ANULOHET aktvendimi nr. 01.3.2.2/25069 i datës 14.02.2022 i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Ardi” Shpk, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke kërkuar që të anulohet vendimi i kontestuar nr.01.3.2.2/25069 datë 14.02.2022, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale. Gjatë

seancës së shqyrtimit kryesor publik, përfaqësuesi i palës paditëse theksoi: Njoftojmë gjykatën se kam vizituar edhe Gjykatën Themelore Administrative, por nuk munda të siguroj provën që ndaj të njëjtit është ushtruar padi." Përfaqësuesi më tej shtoi: Konsiderojmë se e paditura ka ndjekur një procedurë të gabuar për çështjen. Ne mbesim pranë deklarimeve tona dhe pretendojmë se paditësi duhet të kthejë një shumë të caktuar, e cila sipas vendimit 07.4/759, 763 të datës 26.03.2014, përkatësisht sipas pretendimit se paditura ka përfituar pa bazë ligjore sipas aktvendimit të lartcekur, duhet të ndiqte një procedurë të rregullt dhe jo para kësaj gjykate. Më tej, përfaqësuesi i paditësit shtoi se vendimi i ZBD Pejë është marrë bazuar në nenin 9 paragrafi 2 të Kodit Doganor dhe të Akcizave (KDA) dhe në nenin 132 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Administrative (LPA). Për këtë arsye, konsiderohet se ZBD Pejë ka tejkaluar kompetencat e saj, pasi neni 132 paragrafi 1 i LPA-së përcakton që organi që ka nxjerrë ose ka refuzuar aktin administrativ të apeluar duhet të pranojë kërkesën për rishqyrtim dhe të marrë një vendim përkatës. Nxjerrja e aktit administrativ nga ZBD Pejë, si një organ i shkallës së parë, për një vendim të Sektorit të Rishqyrtimeve është krejtësisht joligjore dhe jashtë kompetencave të ZBD Pejë. Po ashtu, vendimi i kontestuar i nxjerrë nga Sektori i Rishqyrtimeve duhet të kishte përfshirë jo vetëm refuzimin e kërkesës së paditësit për rishqyrtim të vendimeve kontestuese, por edhe kthimin e mjeteve që paditësi i ish-in kthyer, pikërisht bazuar në vendimin e lëshuar nga Sektori i Rishqyrtimeve. Për këto arsye, konsiderojmë se së pari kjo gjykatë nuk është kompetente për shqyrtimin dhe, së dyti, vendimi i nxjerrë në shkallën e parë nga e paditura është nxjerrë jashtë kompetencave. Ne mbesim pranë kërkesëpadsisë dhe kërkojmë anulimin e vendimit kontestues 01.3.2.2/25069 të datës 14.02.2022.

E paditura, në përgjigjen e saj ndaj padsisë, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadsinë e paditësit si të pabazuar. Ajo ka shtuar se vendimi i atakuar është marrë në përputhje të plotë me dispozitat në fuqi dhe pretendimet e palës paditëse, se ky vendim është marrë me shkelje ligjore, nuk qëndrojnë. E paditura arsyetoi se vendimi i atakuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa pala paditëse nuk ka arritur të vërtetojë pretendimet e saj me asnjë provë të vetme. Për këtë arsye, i propozon gjykatës që padia dhe kërkesëpadsia e paditësit të refuzohen si të pabazuara dhe vendimi kontestues të mbetet në fuqi si i ligjshëm. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e palës së paditur ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe sqarimeve të dhëna më parë, duke i elaboruar ato si në arsyetimin e aktvendimit kontestues. Ajo shtoi se ZBD Pejë, bazuar në aktvendimin për rishqyrtim të aktvendimeve, ka nxjerrë aktvendim për inkasimin e mjeteve për deklaratat e përmendura në aktvendimin kontestues, dhe duke pasur parasysh se kthimi i mjeteve është bërë bazuar në

aktvendimin e Bordit të cilin Gjykata e Apelit e ka anuluar duke miratuar ankesën e Doganës së Kosovës, Dogana ka obliguar paditësin që të bëjë kthimin e mjeteve të kthyer në shumë prej 10,542.95 euro.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata, në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor-publik, ka administruar provat si në vijim: Aktvendim 01.3.2.2/25069 datë 14.02.2022, Ankesë në Doganë më datë 20.12.2021, Aktvendim i ZBD Pejë nr.02.5.1/22792/1 datë 18.11.2021, Aktvendim 07.4/759 dhe 763 datë 26.03.2014, Aktvendim 07.4/759 dhe 763 datë 16.07.2009, Aktvendim 07.4/759 dhe 763/2001 datë 02.04.2020, Aktgjykim A.nr.1007/18 datë 15.01.2020 dhe Aktgjykim AA.nr.97/2014 datë 12.04.2018.

Gjykata, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, deklarimeve në seancë dhe shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, vlerësoi secilën provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar-administrativ duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar-administrativ, përfshirë deklaratimet në ankesë, shkresat e lëndës, aktvendimin kontestues dhe deklaratimet gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata ka konstatuar se paditësi ka deklaruar mallin për zhdoganim në Zyrën Doganore Pejë, me ç'rast, pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-ave kontestues, Dogana e Kosovës ka aplikuar metodën e katërt dhe gjashtë të vlerësimit, sipas çmimit të tregut dhe të dhënave të Doganës së Kosovës, pasi që sipas të paditurës paditësi kishte deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar apo që do të paguhet për mallin e shitur për eksport ose import. Dogana e Kosovës ka theksuar se është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit (neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave), si dhe për disa emërtime specifike në DUD, ka përdorur metodën e katërt (neni 34 par.2 pika c) të Kodit Doganor dhe të Akcizave).

Gjykata ka konstatuar më tej se dokumentacioni përcjellës i mallit nuk ishte pranuar për shkak të mungesës së deklaratës eksportuese dhe faktit që fatura nuk ishte vulosur nga autoritetet doganore. E paditura ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit nr. 5201/14.04.2009 të ZBD Pejë. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, me Aktgjykimin nr. 1007/18 të datës 15.01.2020, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke anuluar aktvendimin nr. 06.1.4/759, 763 të datës 16.07.2009 dhe e ka kthyer

lëndën për rishqyrtim të paditura. E paditura, duke vepruar sipas këtij aktgjykimi, me aktvendimin nr. 06.1.4/759, 763/2009 të datës 02.04.2020, ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve nr. 7407/17.05.2009, 7460/18.05.2019 dhe 7665/20.05.2009 të ZBD Pejë, si dhe duke e hedhur poshtë kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit 5201/14.04.2009 të ZBD Pejë si të ushtruar jashtë afatit ligjor. Tutje, Zyra e Brendshme Doganore Pejë ka nxjerrë aktvendim me të cilin ka obliguar paditësin që të paguajë mjetet e kthyera, sipas aktvendimit të Sektorit të Rishqyrtimeve të Doganës së Kosovës, me nr. 07.4/759 dhe 763, të datës 26.03.2014, në shumën prej 10,542.95 euro.

Në mes të palëve mbetet kontestuese çështja nëse ZBD Pejë ka qenë kompetente që të nxjerrë aktvendim për obligimin e paditësit për kthimin e mjeteve në vlerën e kontestit të kësaj padie.

Gjykata, duke analizuar arsyetimin e vendimit kontestues, konstaton se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Këto të meta konsistojnë në faktin se arsyetimi lidhur me refuzimin e ankesës së paditësit është i pamjaftueshëm dhe nuk përputhet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës.

ZBD Pejë e ka mbështetur aktvendimin për inkasimin e mjeteve në nenin 9 par. 2 të Kodit Doganor dhe të Akcizave si dhe në nenin 132 par. 1 të Ligjit mbi Procedurën Administrative. Në arsyetimin e këtij aktvendimi, është theksuar se me aktvendimin nr. 06.1.4/759 dhe 763/2009, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e paditësit, vendimi përfundimtar ka mbetur në fuqi. Me të njëjtin vendim, Zyra Doganore Pejë është obliguar që për deklaratat unike të përmendura në dispozitiv të nxjerrë aktvendim të ri dhe të inkasojë mjetet e kthyera sipas aktvendimit të Sektorit të Rishqyrtimeve të vendimeve.

Gjykata ka elaboruar dispozitat ligjore në të cilat e paditura e ka mbështetur vendimin kontestues dhe nga këto dispozita rezulton se neni 9 par. 2 i Kodit Doganor dhe Akcizave përcakton që Dogana ka për detyrë të vlerësojë, caktojë dhe mbledhë të gjitha detyrimet doganore dhe taksat në importe dhe eksporte, si dhe të ndërmarrë funksionet e tjera të caktuara nga ligji. Ndërsa neni 132 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton se organi epror do të shqyrtojë ankesën dhe, nëse është e nevojshme, do të zhvillojë shqyrtime shtesë apo do të urdhërojë organin kompetent që të zhvillojë shqyrtime të tilla.

Nga analiza e aktvendimit kontestues dhe aktvendimit mbi të cilin Zyra e Brendshme Doganore (ZBD) Pejë ka mbështetur inkasimin e mjeteve nga paditësi, Gjykata konstatoi se ky aktvendim nuk ka mbështetje të mjaftueshme ligjore në dispozitat e përmendura. Nuk rezulton se ZBD Pejë ka pasur kompetencë ligjore për të obliguar paditësin për të kthyer mjetet tashmë të marra nga paditësi nga Dogana e Kosovës sipas vendimit të mëparshëm. E paditura detyrohet të deklarojë bazën ligjore dhe mënyrën në të cilën ka nxjerrë aktvendimin për kthimin e mjeteve nga paditësi. Ajo gjithashtu duhet të sqarojë nëse aktvendimi, me të cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim të vendimeve 7407/17.05.2009, 7460/18.05.2019 dhe 7665/20.05.2009 të ZBD Pejë, është i ekzekutueshëm, dhe nëse ekzekutimi i tij duhet të realizohet përmes ZBD Pejë, duke marrë parasysh dispozitat ligjore përkatëse. Të sqarohet se si është obliguar ZBD Pejë të veprojë, duke marrë parasysh se me aktvendimin nr. 06.1.4/759,763/2009 nuk është dhënë një obligim i tillë. Në arsyetimin e vendimit, ZBD argumenton se me këtë aktvendim ajo është obliguar të nxjerrë aktvendim të ri dhe të inkasojë mjetet e kthyer sipas aktvendimit nr. 07.4/759 dhe 763 të datës 26.03.2014, andaj rezulton se ka kundërtënie ndërmjet vendimit kontestues, vendimit të ZBD-së, si dhe vendimit nr. 06.1.4/759,763/2009.

Të metat e përmendura janë të natyrës që e bëjnë të pamundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Prandaj, aktvendimi i atakuar duhet të anulohet dhe të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

Dogana e Kosovës obligohet të rishqyrtojë të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të vlerësojë drejt dhe plotësisht gjendjen faktike në përputhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Kodit Doganor dhe të Akcizave.

Neni 43 paragrafi 1 dhe 2 i LKA-së i jep gjykatës kompetencën për të anuluar aktet administrative kur konstaton se këto akte janë marrë në kundërshtim me ligjin ose kanë të meta në përmbajtje. Paragrafi 1 përcakton që gjykata anulon vendimin e organit administrativ nëse konstaton që ai është i paligjshëm. Paragrafi 2 i këtij neni përcakton që gjykata mund të urdhërojë organin administrativ të rishikojë aktin administrativ në përputhje me udhëzimet e saj.

Në rastet kur vendimi i organit administrativ është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, siç është vlerësuar në këtë rast për ZBD Pejë, gjykata ka kompetencën jo vetëm ta anulojë atë vendim, por edhe të urdhërojë organin që ta rivlerësojë dhe ta rivendosë çështjen duke ndjekur procedurat e

ligjshme dhe udhëzimet e gjykatës. Qëllimi është që të sigurohet që vendimi i ardhshëm të jetë në përputhje me ligjin dhe të drejtën e paditësit.

Në këtë rast konkret, gjykata ka konstatuar se vendimi i ZBD Pejë është marrë pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe me tejkalim të kompetencave. Duke u mbështetur në nenin 43 par. 2 dhe nenin 46 par. 1 dhe 2, gjykata e anulon aktvendimin dhe e kthen çështjen për rishqyrtim te organi administrativ, me detyrimin që ky i fundit të veprojë në përputhje me udhëzimet e gjykatës dhe dispozitat ligjore të lartpërmendura.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal  
KF.nr.601/22, datë 27.09.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.